


Për nevojat e Sekretariatit për Çështje Evropiane për periudhën gusht 2013 - nëntor 2014 u realizuan tre hulumtime të opinionit publik lidhur me qëndrimin e publikut për procesin eurointegrues të Republikës së Maqedonisë. Hulumtimi u krye nga Brima, në terren, ballë për ballë, me një mostër të veçantë prej rreth 1.200 të anketuar. Hulumtimet për muajin gusht 2013 dhe shkurt 2014 u mbështetën financiarisht nga Instituti Kombëtar Demokratik - NDI, ndërsa hulumtimi i fundit i kryer në muajin nëntor u mbështet financiarisht nga Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar - GIZ.

Përgjigjet në pyetjen: „A mbështetni Ju personalisht anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në BE dhe NATO?“ qartë tregojnë përcaktimin mbizotérues pozitiv të qytetarëve në lidhje me drejtimin evropian të cilin e ka marrë Republika e Maqedonisë, pavarësisht regjistrimit të një rënie të vogël. Përqindja e të papërcaktuarve është jashtëzakonisht e ulët, që tregon një perceptim mirë të zhvilluar të publikut për agjendën e Evropiane.

Sa i përket pyetjes së dytë „Duke marrë parasysh të gjitha gjërat, do të kishit thënë se Maqedonia do të kishte ose nuk do të kishte dobi nga anëtarësimi në BE?“ shumica e të anketuarve mendojnë se Maqedonia do të kishte dobi nga anëtarësimi në Bashkimin Evropian.

P1. A mbështetni Ju personalisht anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në BE dhe NATO?

(Të dhënat janë të grumbulluara: mbështetje e plotë + e pjesshme = e mbështes, aspak + pjesërisht nuk e mbështes = nuk e mbështes)



P2. Duke marrë parasysh të gjitha gjërat, do të kishit thënë se Maqedonia do të kishte ose nuk do të kishte dobi nga anëtarësimi në BE?

